

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME” DIBËR sh.a
DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTETËSE
SEKTORI JURIDIK DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot

Date, me 23.06.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Tarifa e mirembatjes sistemi i faturimit fiskalizimit per SHRUK-Diber sha”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): *Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit*

Vlera e fondit limit: *ne vlerën 3 980 000 (Tre milion e nenteqinde e tetedhjetë mijë) lekë pa tvsh.*

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj nga momenti i lidhjes se kontrates.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Dibër sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10,*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas kritereve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e mëposhtme “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”*.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe këstin përkatës për vitin 2026, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30. 10. 2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvorje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". *Per kontrata e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*"".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim :

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- **ISO 9001 (për Standartin e Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente**

Argumentimi: Përmbytja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbytjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

- **ISO 27001 – Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit ose ekuivalente**

Argumentimi: Ky standard përcakton kërkesat për një Sistem Menaxhimi të Sigurisë së Informacionit (ISMS). Synon të mbrojë informacionin konfidencial, të garantojë integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe të menaxhojë rreziqet kibernetike në organizatë.

- **ISO 20000-1 (për Sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit) ose ekuivalente**

Argumentimi: Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo certifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dekumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.4.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 7 (shtatë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), si më poshtë:

Të paktën 2 (dy) punonjës ku një të jetë i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e Flare Billing ose ekuivalent, një të jetë i certifikuar nga prodhuesi në zhvillimin e e zgjidhjes së fiskalizimit.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Certified SOA Professional (profesionist i certifikuar për arkitekture orientuar nga shërbimet) ose ekuivalent.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti PMP ose ekuivalent.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).

Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar si Profesionist në Sigurim Ofensiv (OSCP ose ekuivalente).

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Diplomat e shkollës së lartë
2. Certifikatat/transcriptet që vërtetojnë certifikimet e mesiperme të kërkuara të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme.

3. Formularet E-SIG per periudhen e 3 (tre) muajve te fundit duke iu referuar datës së zhvillimit të procedurës

Shënim: *Një punonjës mund të disponojë edhe më shumë se një certifikate.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktuese përcaktojnë kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë duke u bazuar në:

- a) Pershtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,
- b) Gjendjen ekonomike dhe financiare,
- c) Aftësinë teknike dhe profesionale."

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilen nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mesiperme të ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar janë kryer në baze të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialistëve. Diplomimi i punonjësve në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termit e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, migrimin dhe instalimin e të gjithë informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të afroje trajnim për përdoruesit.

- a) Nisur nga instalimi i licencave, proceset e shumta dhe delikate që proceson Programi Flare Billing, historiku në vite të abonenteve, madhësia e konsiderueshme e databazës, është e domosdoshme që OE të ketë punonjës të certifikuar në zhvillim nga prodhuesi ose ekuivalent për Programin Flare Billing ose ekuivalent, pasi me anë të këtij certifikimi OE garanton shoqërinë që ka të gjithë burimet njerzore të nevojshme për të finalizuar me sukses të gjithë shërbimet që kërkojnë. Gjithashtu kërkohet dhe një punonjës të certifikuar për zgjidhjen e fiskalizimit që do të ofrohet i cili do të garantojë si integritet të sigurt ashtu edhe mirëmbajtje për gjatë gjithë periudhës së kontratës.
- b) Ky punonjës është i nevojshëm për të garantuar shoqërinë që integrimi do të jetë efektiv mes programeve të brendshme dhe atyre të palëve të treta sic janë institucionet Financiare Banke dhe jo Banke. Certifikatat përkatëse vërtetojnë që programuesi disponon aftësi të specializuara në zhvillimin e aplikacioneve me arkitekturë të orientuar drejt shërbimeve në rrjet (service-oriented) dhe sistemeve të shpërndara. Kjo ekspertizë është thelbësore për të siguruar një integritet të besueshëm dhe të qëndrueshëm me institucionet financiare, bankare dhe jobankare, me të cilat sistemi aktual shkëmben të dhëna për rakordimin automatik të detyrimeve dhe pagesave të abonentëve. Këto integritete realizohen përmes përdorimit të protokolleve të standardizuara si SOAP, REST ose protokolle të tjera ekuivalente, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike të projektit.

- c) Ky punonjës garanton shoqerine se OE disponon burime njerzore me aftësi të avancuara profesionale, të nevojshme për realizimin e projektit në përputhje të plotë me kërkesat, afatet dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST). Punonjësi i certifikuar si Menaxher Projekti siguron organizimin efektiv të burimeve njerëzore dhe teknike të OE, duke mundësuar zbatimin e suksesshëm të projektit sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të menaxhimit të projekteve.
- d) Ky punonjës garanton që rezultatet që duhet të permbushen nga OE, sipas kërkesave të DST ku janë të përcaktuara kohet e nderhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirembajtjes). Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kjo kërkesë i deshmon autoritetit kontraktor që operatori ekonomik (nepermjet stafit të certifikuar si me sipër, garanton ideimin, konceptimin e shërbimeve IT të projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA, sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë ketu dhe shërbimet e mirembajtjes që janë shumë të rëndësishme për AK dhe të vëna në dukje në DST dhe specifikime teknike.
- e) Certifikimi CISA (Certified Information Systems Auditor) ose ekuivalent është një standard i njohur ndërkombëtarisht që vërteton njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale në auditimin e sistemeve të informacionit, vlerësimin e kontrolleve të teknologjisë së informacionit, identifikimin e dobësive dhe menaxhimin e rreziqeve që lidhen me sigurinë dhe integritetin e sistemeve. OE duhet të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar CISA ose ekuivalent, i cili zotëron ekspertizën e nevojshme për kryerjen e auditimit të sistemeve të informacionit, vlerësimin e proceseve dhe kontrolleve të TI-së, si dhe identifikimin e rreziqeve dhe mangësive që mund të ndikojnë në sigurinë, disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave. Prania e një eksperti të certifikuar CISA ose ekuivalent garanton se OE disponon kapacitetet profesionale për të kryer auditime në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë vlerësimin e procedurave, politikave, rregulloreve dhe mekanizmave të administrimit të sigurt të teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, ky certifikim siguron që auditimi të realizohet sipas parimeve të pranueshme të auditimit të sistemeve të informacionit, duke garantuar cilësinë e procesit dhe besueshmërinë e gjetjeve dhe rekomandimeve që do t'i paraqiten shoqërisë. Në kuadër të objektit të kontratës, ky kriter synon të sigurojë që OE të ketë personel të kualifikuar dhe të aftë për të kontribuar në identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve ekzistuese dhe përmirësimin e nivelit të sigurisë së sistemeve objekt auditimi. Për të garantuar qëndrueshmërinë, sigurinë dhe përputhshmërinë e sistemeve me standardet dhe kërkesat rregullatore në fuqi, është e nevojshme një qasje e integruar që kombinon menaxhimin e sigurisë së informacionit me auditimin e sistemeve të informacionit. Ky version shmanë përsëritjet dhe ka gjuhë më të përshtatshme për specifikime teknike dhe argumentim kriteresh në procedurat e prokurimit publik.
- f) Kërkesa për profesionist të certifikuar OSCP (Offensive Security Certified Professional) ose ekuivalent. Përfshirja në ekip të paktën 1 (një) profesionisti të certifikuar OSCP ose ekuivalent është e nevojshme për të garantuar sigurinë, integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemeve objekt kontrate. Certifikimi OSCP ose ekuivalent vërteton njohuri dhe aftësi të avancuara praktike në identifikimin, analizimin dhe testimin e dobësive të sigurisë në sisteme, aplikacione dhe infrastrukturë teknologjike, duke mundësuar zbulimin proaktiv të rreziqeve dhe cenueshmërive të mundshme. Profesionisti i certifikuar OSCP ose ekuivalent zotëron kompetencat e nevojshme për kryerjen e testeve të sigurisë, vlerësimin e ekspozimit ndaj kërcënimeve kibernetike dhe verifikimin e efektivitetit të mekanizmave mbrojtës

të implementuar. Këto aftësi janë veçanërisht të rëndësishme gjatë proceseve të mirëmbajtjes, integritetit të komponentëve të rinj, ndryshimeve të konfigurimeve apo zhvillimeve të mëtejshme të sistemit, të cilat mund të krijojnë dobësi të reja të sigurisë. Në kuadër të realizimit të kontratës, profesionisti i certifikuar do të kryejë testime të sigurisë të tipit Black Box dhe White Box, të cilat konsiderohen metoda të domosdoshme për identifikimin e dobësive në aplikacione dhe sisteme informacioni. Testimet Black Box simulojnë veprimet e një përdoruesi ose sulmuesi të jashtëm pa njohuri mbi arkitekturën e brendshme të sistemit, ndërsa testimet White Box mundësojnë analizimin e komponentëve të brendshëm, logjikës së aplikacionit, konfigurimeve dhe mekanizmave të kontrollit të aksesit. Kombinimi i këtyre metodologjive siguron një vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të nivelit të sigurisë së sistemit. Gjithashtu, disponimi i një eksperti të certifikuar në këtë fushë kontribuon në përputhshmërinë e zgjidhjes me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të sigurisë së informacionit, duke garantuar një nivel më të lartë besueshmërie në realizimin e shërbimeve të kërkuara. Profesionisti do të jetë përgjegjës për dokumentimin e gjetjeve, analizimin e ndikimit të dobësive të identifikuara dhe formulimin e rekomandimeve konkrete për adresimin e tyre, në bashkëpunim me ekipet teknike dhe zhvilluesit e sistemit. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë që Operatori Ekonomik disponon kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për identifikimin, menaxhimin dhe minimizimin e rreziqeve të sigurisë, si dhe për garantimin e funksionimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemeve objekt kontrate. Kjo kërkesë është përcaktuar në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, duke lejuar paraqitjen e certifikimeve ekuivalente dhe mundësinë që një punonjës të zotërojë më shumë se një certifikim të kërkuar, pa krijuar kufizime të panevojshme për konkurrencën.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues të paraqesë certifikatë nga AKSHI, në bashkëpunim me administratën tatimore qendrore, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të këtyre zgjidhjeve software-ike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori, ku të autorizohet operatori për shitjen e licensave të produkteve software dhe kryerjen e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurimi. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit. Dokumentacioni të jete në gjuhën shqipe ose e përkthyer në shqip, si dhe të ketë të gjithë kontaktet (nr telefoni, E-mail) si dhe adresën web të prodhuesit apo Distributorit për konfirmim të dokumentave të paraqitura. Të jete e përcaktuar emri, nipi dhe adresa fizike e operatorit ekonomik. Autorizimi të ketë edhe datën e lëshimit përpara datës së zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Me anë të këtij kriteri, shoqëria kërkon garanci që OE disponon të drejtën zyrtare për ofrimin e shërbimeve objekt të këtij prokurimi, të cilat përfshijnë instalimin, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe suportin e komponentëve software të sistemit.

Ky kriter siguron vijueshmërinë e shërbimit, shmangien e problematikave gjatë implementimit dhe operimit të sistemit, si dhe garanton mbështetjen e prodhuesit ose distributorit në proceset kritike si integriteti me palë të treta, implementimi i mjediseve të rikuperimit nga fatkeqësitë (DR), si dhe mirëmbajtja e qëndrueshme e sistemit gjatë gjithë ciklit të kontratës.

Gjithashtu, autorizimi nga prodhuesi ose distributori garanton që shërbimet do të realizohen në përputhje me standardet teknike të rekomanduara dhe kërkesat e sigurisë të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe praktikatat ndërkombëtare të fushës së teknologjisë së informacionit.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Hyrje

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber përfshin 4 (kater) njësi bashkiake me një shtrirje gjeografike të konsiderueshme dhe ka rreth **24 814 (Njezete e kater mije e teteqinde e katermbdhjete mije) abonentë**.

Aktiviteti i shoqërisë është totalisht i varur nga programi i faturimit, funksionalitetet e tij dhe mirëmbajtja për gjatë gjithë periudhës.

Programi duhet të integrohet dhe me institucione të tjera banke dhe jo banke për të bërë të mundur arkitime nga pale të treta.

Kjo shoqëri disponon një Program Faturimi **Flare Billing** i cili kërkon instalimin e licencave për të aktivizuar. Programi ka qenë në përdorim dhe operon në cloud për gjatë shumë viteve dhe është i njohur edhe nga përdoruesit.

Me anë të këtij programi shoqëria menaxhon të gjithë të dhënat e abonenteve, hedh leximet e matësve, gjeneron faturat dhe gjithashtu hedh dhe arketimet.

Bazuar në Ligjin Nr. 87/2019 “Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” dhe Udhëzimit nr. 16 datë 03. 04. 2020 “Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit” dhe Vendimit Nr. 239 datë 20. 03. 2020 “Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike”

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber kërkon të aktivizojë një program fiskalizimi të integruar me programin e faturimit i cili përfshin në funksionalitetet e tij dhe fiskalizimin automatik të faturave thjesht duke u integruar me një program fiskalizimi.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Diber shpesh është përcaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe e rëndësishme e informacionit. Për këtë arsye, kërkohej krijimi i një site DR në cloud i cili do të bëjë të mundur shmangjen e çdo incidenti me të dhënat e abonenteve si dhe do të garantonte vijueshmërinë e punës në rast të rënies së serverit primar.

Sherbimet që kerkohen:

1. Blerje dhe instalim i licencave për Programin Flare Billing.
2. Blerje dhe instalim i licencave për Programin e Fiskalizimit që do të ofrohet në cloud.
3. Krijimi i Disaster Recovery.
4. Mirëmbajtja e Programit Flare Billing dhe Programi I Fiskalizimit që do të ofrohet në cloud.

Kërkesat teknike

1. Instalimi i licencave.

Instalim i Licencave Flare Billing duke aktivizuar programin në Cloud bashkë me funksionalitetet e tij.

Instalim i Licencave për Programin e Fiskalizimit që do të ofrohet dhe integrimi i tij me programin e faturimit duke bërë të mundur që funksionet në programin Flare Billing për fiskalizimin të behen aktive për të bërë të mundur fiskalizimin e faturave në mënyrë automatike.

2. Cloud-i i Programit Flare Billing dhe Disaster Recovery

a. Arkitektura

- 2 serverë aplikativë (Active/Standby)
- 1 server database primar + 1 replikim në zonë tjetër brenda BE
- Failover automatik i testuar
- Redundancë energjie dhe rrjeti
- Load Balancer
- Web Application Firewall
- Centralized Logging
- SIEM integrim

b. Disponueshmeria

- Downtime maksimal: ≤ 3 ore / muaj

c. Backup

- Daily incremental backup
- Weekly full backup

d. Mbrojtja

- Firewall deny-by-default WFA
- IDS/IPS aktiv
- DDoS Protection për PDA Reader dhe Self-Care Portal
- MFA për administratorë
- Kriptim TLS 1.2+ dhe database at rest

e. Vulnerabiliteti

- Scan periodik çdo 3 muaj
- Patch brenda 7 ditëve për vulnerabilitetet kritike
- Raport sigurie mujor
- Incident Reporting
- Raportim ≤ 24 orë
- Operator si Processor
- Data breach $\rightarrow$ raportim ≤ 24 orë
- Log auditimi ≥ 12 muaj

3. Mirembatje e Programit Flare Billing dhe programit te Fiskalizimit qe do te ofrohet

- Up Date te komponenteve te Programit Flare Billing.
- Zgjidhje te incidenteve te ndryshme qe mund te vijne nga problematika te ndryshme.
- Sistemime te bug-eve qe mund te shfaqen gjate Up Date te ndryshme.
- Dokumentim i çdo upgrade me version, datë, dhe ndryshime të kryera.

4. Kërkesat teknike per programin e Fiskalizimit

- Të regjistrojë shpejt dhe lehtë faturat elektronike, ku përfshihen faturat elektronike, faturat pa para ne dore, faturat me para ne dore, faturat shoqeruese dhe dhe veprimet e arkave.
 - Të jetë i integruar me programin e faturimit Flare Billing që disponon SHRUKD SH.A.
 - Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga programi i faturimit dhe të fiskalizohen.
 - Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e faturimit Flare Billing, si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.
 - Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.
- ✓ Sistemi duhet të gjenerojë raporte mujore të strukturuar sipas kategorive të mëposhtme:
- Fiskalizimi i faturave sipas llojit të faturës: fatura me para në dorë, fatura pa para në dorë (bankë), fatura shoqëruese, fatura manuale, fatura API (fatura të gjeneruara automatikisht nga programi i faturimit Flare Billing dhe të transmetuara në sistemin e fiskalizimit nëpërmjet integritetit API, pa ndërhyrje manuale)
 - Fiskalizimi i faturave sipas shërbimeve të Shoqërisë: pikë lidhje, hapje kontrate, tarifë kanalizimi, tarifë shërbimi për përdorim autoboti, vendosje matësi, gjoba, taksa të ndryshme
 - Totali i vlerës financiare të faturave (me dhe pa TVSH)
 - Statusi i faturave (të pranuar, të refuzuara nga sistemi i tatimeve, në proces)
 - Raport për aktivitetin e përdoruesve (audit log)
 - Të gjitha raportet duhet të jenë të eksportueshme në format: Excel, PDF, CSV, si dhe të ofrojnë mundësi filtrimi sipas datës, llojit të faturës, shërbimit dhe përdoruesit.

Operatori Ekonomik duhet të këtë zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- Krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
- Vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- Dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
- Lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- Transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit
- Konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;
- Ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
- Gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);

- Gjenerimin e kodit QR;
- Printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- Të sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit.
- Sipas nenit 9 të Ligjit, për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të faturave të lëshuara, Elementi i detyrueshëm i secilës faturë është, ndër të tjera, NIVF, i cili identifikon në mënyrë unike çdo faturë dhe konfirmon që fatura është regjistruar në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore.

Funksione të tjera që duhet të ketë programi:

- Bazat e të dhënave, të jenë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi
- Të ofrojë mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cilit përdorues apo rol ; të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara
- Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
- Të hap llogari për operatorët përdorues sipas kërkeses së AK si dhe një llogari administrator i cili të mund të shikojë veprimet e tij dhe të tjerëve si dhe të gjenerojë raportet e nevojshme lidhur me librat e shitjeve, librat e blerjeve, artikujve etj.
- Të ofrojë mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara
- Të mundësojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
- Të mundësojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
- Të mundësojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë paramodifikimit.
- Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.

Kategoria e Incidentit	Koha e Reagimit	Koha Maksimale e Zgjidhjes
Kritik (Sistemi offline / faturim i bllokuar)	≤ 1 orë	≤ 12 orë
Mesatar	≤ 2 orë	≤ 24 orë
I Ulët	≤ 4 orë	≤ 48 orë

Argumentim:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Komisioni i ngritur për vendosjen e specifikimeve teknike bazuar në legjislacionin e sipërcituar ka vendosur specifikimet teknike bazuar në fushën e veprimtarisë për Sitemin e Faturimit që disponon Shruk Diber Sha.

Bazuar në nevojën për ripërsëritje të licensave të programit si dhe për mirëmbajtjen e tij e cila është e domosdoshme dhe e nevojshme për tu bërë çdo vit

Sa sipër komisioni ka përcaktuar e specifikimet e mësipërme .

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim

NJESIA E PROKURIMIT